Kronikë

Grabitën lokalin në Kavajë dhe kanosën me armë pronarin që të mos kallëzonte krimin, arrestohen 2 hajdutët, autorë të disa vjedhjeve të tjera

Dy persona janë arrestuar pasi akuzohen si autorë të disa grabitjeve në Kavajë, Tiranë, Krujë, Kukës e Pukë. Rasti më i fundit ishte grabitja e një lokali në Kavajë dhe kanosja e pronarit që të mos kallëzonte krimin.

Redaksia
14 Mars, 09:20 | Përditesimi i fundit: 14 Mars, 09:39

Nje det me oferta te pret...
zbulo me teper ne booking.adriaferries.com

Dy persona janë arrestuar pasi akuzohen si autorë të disa grabitjeve në Kavajë, Tiranë, Krujë, Kukës e Pukë. Rasti më i fundit ishte grabitja e një lokali në Kavajë dhe kanosja e pronarit që të mos kallëzonte krimin.

Pas denoncimit, policia nisi operacionin 'Shtegtarët', ku në pranga ranë Besjan Dedaj, 33 vjeç nga Fushë Kruja e Sajmir Voka, 28 vjeç nga Tirana.



LEXO EDHE:
Rritja e çmimeve, për të gjashtën ditë radhazi në protestë përpara kryeministrisë, qytetarët të paktë në numër

Si ndodhi ngjarja? Dy autorët në një lokal në Golem, kanë vjedhur televizorë e sende të tjera, dhe pas disa ditësh, kanë shkuar përsëri në lokal dhe kanë kanosur me armë zjarri pronarin e lokalit, për të mos kallëzuar. Gjithashtu nën kërcënimin e armës, me qëllim që klientët të mos tregonin e të mos njoftonin Policinë, u kanë marrë 4 klientëve, aparatet celulare dhe janë larguar.

Dy të arrestuarit janë autorë edhe të vjedhjes së një banese në Kavajë, si dhe disa automjeteve që i kanë çuar për pjesë këmbimi në Kukës.

Gjatë aksionit u sekuestruan 1 kallshikov, një sasi municioni luftarak si dhe një shumë parash 700.000 lekë të rinj, të dyshuara të përfituara nga kjo veprimtari kriminale.

Materialet i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Kavajë, për veprat penale "Vjedhja me dhunë", "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit", "Vjedhja" dhe "Kanosja për të mos kallëzuar", kryer në bashkëpunim, për veprime të mëtejshme procedurale.

BUNK'ART 1

I.K./Shqiptarja.com

TAG: Tirane kavaje grabitje Arrestime Besjan Dedaj Sajmir Voka

Komento

© Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
A mjaftojnë 7 masat e Paketës së Rezistencës Sociale për të përballuar rritjen e çmimeve?

Po Jo Nuk e di

Lajme të tjera

Kronikë

Aksident në Bathore, makina del nga rruga, plagosen dy pasagjerët! Arratiset shoferi
14 Mars, 16:27

Kosova & Rajoni

Kosovë, arrestohen 48 policë të kufirit për ryshfet dhe shpërdorim detyre, të përfshirë dhe efektivë nga Shqipëria
14 Mars, 13:46

Kronikë

Gjykata e Lartë e ka shpallur të pafajshëm, policia e Elbasanit e arreston, e mban në burg prej 24 orësh

Arsen Rusta
14 Mars, 12:08

Ekonomi

Nga 2 mln lekë deri në heqje të licensës, zbardhen ndëshkimet e Bordit të Hidrokarbureve ndaj pikave të karburanteve që abuzojnë me çmimin
14 Mars, 11:55

Kultura

Kori Arbëresh 'Lule Sheshi' me muzikën e të parëve, jehon polifonia 6-shekullore

Anila Dedaj
13 Mars, 19:21

Sociale

I ikën tmerrit të luftës, strehohet familja e parë ukrainase në Tiranë
13 Mars, 18:58

Kronikë

Po kalonin me furgon 4735 kg 'Guda' kontrabandë në Qafëbotë për ta tregtuar në Shqipëri, arrestohen 3 presona, njeri prej tyre doganier
13 Mars, 18:01

Kronikë

Protesta kundër rritjes së çmimeve, lihen të lirë 45 qytetarët që u arrestuan në Tiranë, Dibër dhe Lezhë
13 Mars, 13:09

Kronikë

Rritja e çmimeve, për të pestën ditë radhazi qytetarët dalin në protestë! Numër më i vogël se ditët e kaluara në të gjitha qytetet! Report Tv sjell pamjet! Protestuesit bllokuan rrugën për rreth 30 minuta
13 Mars, 11:08

Sociale



VIDEO/ Dy orë protestë, Report Tv sjell pamjet me dron, ja sa protestues janë para kryeministrisë
12 Mars, 13:09

Sociale



'Opozita që po vjen do i dali zot këtij populli', qytetarët zbresin nga podiumi protestuesin: Poshtë politika, në shesh është populli
12 Mars, 12:10

Sociale

Rritja e çmimeve/ Mbyllet pas më shumë se 3 orësh protesta e qytetarëve në Tiranë: Boll na vodhët! Nesër sërish në shesh! Rama: Pakicë e çartur! Gati plani anti-krizë (VIDEO)
12 Mars, 10:29

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com
GetButton

© 2011 - 2022 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje